



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 13.03.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **08.03.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Gene Medicals sh.p.k.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me Barna nga Lista Esenciale"** Lot 30 me nr. prokurimi 206-24-582-1-1-1, nxjerr:

**V E N D I M**

1. **PRANOHET**, si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **Gene Medicals sh.p.k.** e dt. 08.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me Barna nga Lista Esenciale"** Lot 30 me nr. prokurimi 206-24-582-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 20.12.2023.
2. Mbetet në fuqi, Njoftimi për Kontratë i datës 06.02.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik **Gene Medicals sh.p.k.** me date 08.03.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me Barna nga Lista Esenciale"** Lot 30 me nr. prokurimi 206-24-582-1-1-1. AK-MSh, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

**Neni 7 Barazia në trajtim/Jo-diskriminimi**

**Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

Methylprednisolon 40mg është produkt farmaceutik në formë pluhuri. Në përshkrimin e juaj tek specifikacionet ju keni cekur "40mg/ml, (si sukcinat natriumi) në flakon 1 mL monodozë dhe flakona 5- mL multi-dozë" "sikurse produkti të jetë i tretur gati për administrim". Pyetja ime në kërkesën për sqarimin e dosjes ka qenë a pranohet

dozimi 40mg i pluhurit sipas kerkes edhe pse ne flakona me vellime te ndryshme dhe pergjigja juaj ka qene percaktuese per vellimin e flakonit 1 deri ne 5ml. Produkti jone si pluhur eshte i vendosur ne flakon 10ml dhe e ka poashtu edhe tretesin konform MA. Kete situatë e kemi pas edhe me heret kur ne SHSKUK poashtu gjate aktivitetit te prokurimit ka pase medyshje por AK ka vendosur te na shperbleje me kontrate pasi sipas mendimit profesional dozimi eshte i sakte 40mg pluhur Methylprednisolon.

Ne kerkojme nga Autoriteti Kontraktues qe te rishqyrtoje kete dosje dhe mos ta kufizon vellimin e flakonit ku gjendet pluhuri i Methylprednisolon-it.

Shume kompani ne MA nuk e kane te cekur kete fakt dhe kjo kalon si e tille. Ne rastin tone gjithqka eshte e cekur. Me kerkesë te autoritetit kontraktues ne do ti ofrojme edhe deshmitë MA, kontraten me SHKSUK (per te njëjtin produkt)

#### **Dëmet materiale**

Nqs nuk pranohet kjo kerkesë atehere kompanise tone do ti shkaktohet nje dem material ne fitimin e supozuar nga tenderi si dhe dem jomaterial per cenimin dhe demtimin e imazhit te kompanisë

#### **Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore**

Pretendimin e juaj ankimor e konsiderojme te bazuar, meqense me te njejten doze eshte kerkuar ky produkt ne aktivitetin e shpallur.

Methylprednisolone	40mg	1ml , 5ml	40mg/ml, (si sukcinat natriumi) në flakon 1 mL monodozë dhe flakona 5- mL multi-dozë	Injeksion
--------------------	------	-----------	--	-----------

Duke u ju referuar LBE, u lejohet produkti juaj Methylprednisolone 40mg, me specifikat e përshkuara ne kërkesën për rishqyrtim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

#### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



**Berat Marmullaku**

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**